



**Të mbrojmë mjedisin për të ardhmen tonë dhe vendin ku jetojmë!**

**Në këtë buletin do të gjeni:**




**Programi "Mbështetje për Aftësinë Përtëritëse dhe Zhvillimin e Gjellbër të Shqipërisë"**



**Trajnimit për Direktivën e Cilësisë të Ajrit**



**MedWaves dhe Agjencia Kombetare e Mjedisit  
"Alternativa të sigurt ndaj kimikateve toksike"**




**Grupi teknik i punës lidhur me treguesit e performancës në fushën e bujqësisë**



**Takimi informues mbi thirrjen për grante**



**Vizita e DPA për riakreditimin e Laboratorit**



**"Të dhënat e hapura"**



**Procedura për informimin paraprak të pëlqimit**

## Programi "Mbështetje për Aftësinë Përtëritëse dhe Zhvillimin e Gjelbër të Shqipërisë"

Në kuadër të aktiviteteve të zhvilluara nga Asistenca Teknike e programit "Mbështetje për Aftësinë Përtëritëse dhe Zhvillimin e Gjelbër të Shqipërisë", u organizua trajnimi tre ditor me temë "Forcimi i Menaxhimit të Mbetjeve dhe Politikat për Përgjegjësitë e Zgjeruara të Prodhuesit" në datat 20–22 Janar 2025 në ambientet e Piazza International.



Trajnimi u fokusua në Ligjin e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, si dhe në kuadrin rregullator mbi plastikën ku nga Sektori i Menaxhimit të Kimikateve ishin përfaqësues dy specialist gjithashtu dhe përfaqësues nga Ministria, Inspektoriat por edhe ekspertë ndërkombëtarë, ekspertë kombëtarë.

## Trajnimet për Direktivën e Cilësisë të Ajrit

Welcome to a series of training events addressing harmonised measurements of emerging pollutants of the new Air Quality Directive



Një seri trajnimesh në Janar-Shkurt 2025, është bashkë-organizuar nga Rrjeti i Laboratorëve të Referencës për Cilësinë e Ajrit (AQUILA), Infrastruktura e kërkimit të aerosoleve, reve dhe gazrave gjurme (ACTRIS), Shërbimet e infrastrukturës kërkimore që përforcojnë kapacitetet e monitorimit të cilësisë së ajrit në Zona Urbane dhe Industriale Evropiane (RI-URBANS) dhe Agjencia Evropiane e Mjedisit (EEA).



Trajnimet u organizuan on-line duke u fokusuar në aspektet e ndotësve në zhvillim dhe kerkesat e Direktivës së Cilësisë së Ajrit (Direktiva (BE) 2024/2881 për cilësinë e ajrit të ambientit dhe ajrin më të pastër për Evropën) e cila është publikuar në nëntor 2024.

Kjo lidhet me objektivin e Bashkimit Evropian drejt ndotjes zero deri në vitin 2050 duke lehtësuar parandalimin e vdekjeve të parakohshme për shkak ndotjes së ajrit. Direktiva e re e cilësisë së ajrit bashkon legjislacionin e vitit 2004 dhe 2008 dhe i përgjigjet rekomandimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë për standartet dhe

udhëzimet për të monitoruar ndotësit shtesë të ajrit, të tilla si grimcat shumë të imëta (UFP) dhe përqendrimit e karbonit të zi (BC).

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte të ofrojë një prezantim të kërkesave të direktivës së re të cilësisë së ajrit:

- 1- Për të përshkruar vlerën e shtuar të implementimit të matjeve të grimcave shumë të imëta (UFP) në vendndodhjet urbane, harmonizimin, kalibrimin, shërbimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve
- 2- Vlerën e shtuar të matjeve të **Shpërndarjes së Madhësisë së Numrit të Aerosoleve**, matjet e shpërndarjes, harmonizimi, shërbimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve.
- 3- Për të prezantuar standartet përkatëse të matjeve dhe gjendjen aktuale në matjet e grimcave shumë të imëta (UFP) dhe shpërndarjes së madhësisë së numrit të aerosoleve
- 4- Dhe rekomandimet e monitorimit të BC në vendndodhje urbane dhe në të paktën gjysma e vendndodhjeve rurale, të vendosura me ndotës të tjerë të ajrit.



## MedWaves dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit "Alternativa të sigurt ndaj kimikateve toksike"

Degradimi i vazhdueshëm i zonës bregdetare të Mesdheut dhe mjediseve detare, së bashku me ndikimet urgjente dhe gjithnjë e në rritje të ndryshimeve klimatike, humbjen e mjeteve të jetesës dhe përkeqësimin dramatik të kushteve sociale në pjesë kyçe të brigjeve jugore dhe lindore të Mesdheut, kanë nxitur zhvillimin e Programit të Detit Mesdhe: Forcimi i Sigurisë Mjedisore (MedProgramme).

MedWaves, si një nga Qendrat Rajonale të UNEP/Mediterranean Action Plan, është qendër për bashkëpunim ndërkombëtar mbi zhvillimin dhe inovacionin bazuar në qasjen për konsum dhe prodhim të qëndrueshëm. Është pjesë e Agjencisë Katalanase të Mbetjeve (Agència de Residus de Catalunya, e referuar si ARC). Që nga viti 2009, Qendra gjithashtu ka operuar në mbështetje të Konventës së Stokholmit, një marrëveshje ndërkombëtare që përfshin 180 vende për të luftuar krijimin

e ndotësve organikë të qëndrueshëm, substanca shumë ndotëse dhe toksike. MedWaves ka një mandat nga Konventat e Barcelonës dhe Stokholmit për të ndihmuar Palët Kontraktuese të tyre në përmbushjen e angazhimeve sipas këtyre traktateve, veçanërisht përmes mbështetjes në kalimin drejt modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit si dhe ekonomisë qarkore.

MedWaves është përgjegjës për Produktin 1.3 të Projektit 1.1: Reduktimi Afatgjatë i POP-ve përmes Aktiviteve Pilot mbi Alternativat e POP-ve të Reja. Nën përgjegjësinë e MedWaves, kjo nismë synon të demonstrojë zëvendësimin praktik të POP-ve të reja përmes adoptimit të alternativave mjedisore të qëndrueshme në vendet mesdhetare.

Në këtë kontekst, u vendos që workshopi mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm dhe shkumën e zjarrfikësve të mbahet në Tiranë.



MedWaves dhe Agjencia Kombetare e Mjedisit organizuan me 26 Mars takim informues “Alternativa të sigurt ndaj kimikateve toksike”, i cili do të fokusohet në PFOS dhe shkumën zjarrfikëse në Shqipëri. Ky takim u financua nga Fondi Global për Mjedisin me anë të UNEP/MAP si agjencia kryesore ekzekutive, ndërsa UNEP vepron si agjencia zbatuese.

Qëllimi i këtij takimi ishte shqyrtimi dhe përshtatja e rregulloreve shqiptare për menaxhimin e shkumës zjarrfikëse që përmban PFOS dhe komponime të tjera POPs, përmes udhëzimeve nga ekspertë ndërkombëtarë për Konventën e Stokholmit dhe Komisionin Evropian.




Ekspertët diskutuan mbi praninë e kimikateve në shkumën zjarrfikëse, trajtimin, asgjësimin dhe protokollet e pastrimit, si dhe kuadrin rregullator dhe standardet ndërkombëtare. Prezantimet ofruan informacion dhe njohuri të plota mbi këtë çështje si dhe nxitën zgjidhje bashkëpunuese midis të gjithë pjesëmarrësve dhe aktorëve të interesuar, ku qëllimi kryesor ishte të demonstrohet zëvendësimi praktik i POPs të rinj përmes adoptimit të alternativave mjedisore të sigurt.

## Grupi teknik i punës lidhur me treguesit e performancës në fushën e bujqësisë

Në datë 9 Prill 2025 pranë Agjencisë së Mbështetjes së Vetqeverisjes Vendore (AMVV) u zhvillua takim i grupit teknik për treguesit e performancës në fushën e bujqësisë, ku pati përfaqësues edhe nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Mbledhjen e hapi z. Stiljan Llavdaniti, Drejtor i Përgjithshëm i Komanduar, AMVV duke përshëndetur dhe falenderuar pjesëmarrësit për praninë e tyre. Ai u shpreh se qëllimi kryesor i takimit ishte reflektimi mbi aspektet pozitive të procesit gjatë vitit të kaluar, si dhe identifikimi i dobësive dhe mangësive me qëllim përmirësimin e mëtejshëm.

Takimi vijoi me prezantimin e rezultateve të Sistemit të Matjes së Performancës 2023 (SMP), në lidhje me fushën e bujqësisë.



Disa nga gjetjet kryesore të raportit vjetor ishin:

- Funkcioni i ujitje-kullimit për mirëmbajtjen e kanaleve dytësore/tretësore u transferua në vitin 2016 bashkive;
- Mirëmbajtja e kanaleve ujitëse rezultoi 23% dhe kanaleve kulluese vetëm 13%;
- 47% e tokave bujqësore janë të pajisura me infrastrukturë ujitëse dhe kulluese;
- Në bashkitë e vogla mirëmbajtja në kanalet ujitëse arrin në shkallën 38%, ndërsa në bashkitë më të mëdha, ky tregues bie deri në 12%;
- Në bashkitë me tokë kryesisht bujqësore, vetëm 15% e kanaleve të ujitjes rezultuan të mirëmbajtura, ndërsa në ato me shumicë pyjesh dhe kullota ky tregues rritet deri në 40%;
- Terrenet kodrinore, kanë aftësi natyrore për pastrim dhe janë më pak të prirura për t'u bllokuar.

### TREGUESIT E BUJQËSISË TË SUGJERUAR PËR T'U SHTUAR

#### Bashkia me një plan shërbimi për ujitjen dhe kullimin

- Përqindja e bashkive që kanë zhvilluar dhe miratuar zyrtarisht një plan të plotë për menaxhimin e shërbimeve të ujitjes dhe kullimit.

#### Përqindja e kanaleve funksionale të ujitjes dhe kullimit

- Ndjek përpjesëtimin e kanaleve të ujitjes dhe kullimit që janë funksionale dhe që kryejnë funksionet e tyre të përcaktuara;
- Një kanal konsiderohet funksional nëse mund të ujisë ose kullojë ujë në mënyrë të suksesshme;
- Vlerësim i besueshmërisë dhe efikasitetit të infrastrukturës ekzistuese për mbështetje të aktiviteteve bujqësore dhe menaxhimin e burimeve të ujit në bashki.

Përfaqësuesi i AKM-së parashtrori pyetje lidhur me mundësinë e propozuar për një tregues që lidhet me kontrollin dhe monitorimin e cilësisë së ujërave. Z. Llavdaniti shprehu mendimin se një tregues i tillë mund të propozohet, por theksoi se duhet të jetë i matshëm dhe i qartë për t'u implementuar me sukses. Ai vijoi duke theksuar se ky është viti i dytë i matjes së performancës, dhe një nga sfidat kryesore mbetet edukimi dhe orientimi i duhur për raportimin e saktë të të dhënave.

Në përmblyllje të takimit anëtarët e grupit të punës ranë dakord lidhur me treguesit e propozuar për SMP 2024, si më poshtë:

- MBZHR do të sigurojë një listë me 14 tregues, nga e cila do të përzgjidhen treguesit përfundimtarë për SMP.
- Përzgjedhja duhet të vijë pas shqyrtimit të indikatorëve dhe të konfirmohen nga MBZHR;

### Takimi informues mbi thirrjen për grante

Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, së bashku me partnerët VIS Albania dhe COSV – Cooperazione per lo Sviluppo, në kuadër të projektit "GreenAL – Mbështetja e Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile", financuar nga SIDA me fonde të Qeverisë Suedeze, organizuan takim informues mbi thirrjen për grante më 22 Prill 2025. Në takim ishin përfaqësues edhe nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Ky takim synonte të ofronte një panoramë të përgjithshme mbi thirrjen për grante, duke i njohur pjesëmarrësit me procedurat e aplikimit, dokumentacionin e nevojshëm, qasjen e projektit, si dhe me kriteret kryesore dhe afatet kohore për aplikim.



Grantet për mjedisin ofrojnë mbështetje financiare për organizatat e shoqërisë civile (OSHC) që synojnë të ndërmarin veprime konkrete dhe investime për përmirësimin e gjendjes mjedisore në një rajon ose bashki të caktuar. Këto grante synojnë të nxisin angazhimin lokal dhe të përforcojnë kapacitetet e OSHC-ve për të adresuar çështje mjedisore në mënyrë të qëndrueshme.

Aplikuesi kryesor duhet të jetë një organizatë jofitimprurëse (OJF) e regjistruar, me përvojë minimale 5 vite në fusha të ngjashme, dhe duhet të formojë partneritet me të paktën dy OSHC të tjera. Aplikimi duhet të përmbajë një propozim të

detajuar që përshkruan objektivat, aktivitetet e planifikuara, rajonin e fokusuar dhe ndikimin e pritshëm mjedisor. Për të qenë të pranueshëm, aplikuesit duhet të tregojnë aftësinë për të menaxhuar fondet dhe për të zbatuar projekte në mënyrë efektive dhe transparente.

Grante të ndryshme janë në dispozicion, përfshirë grante rajonale, të cilat mbështesin projekte me ndikim të madh dhe afatgjatë, dhe grante iniciative, që synojnë projekte më të vogla, por inovative dhe të shpejta në zbatim.

Kostot dhe buxheti i projektit janë elementë thelbësorë të aplikimit. Vetëm kostot e pranueshme do të mbulojnë nga granti, të tilla si shpenzimet për pajisje, personel, aktivitete ndërgjegjësuëse dhe trajnime. Kostot e papranueshme, si shpenzimet personale, investimet jashtë fushës së projektit apo shpenzime të pajustificuara, nuk do të mbështeten financiarisht.

Përfituesit e granteve inkurajohen të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm lokal, duke përqendruar veprimtarinë e tyre në një zonë të caktuar dhe duke krijuar ndikim pozitiv dhe të matshëm në mjedis. Kjo iniciativë synon të forcojë rolin e OSHC-ve në mbrojtjen e mjedisit dhe të krijojë partneritete të qëndrueshme për të ardhmen

### Vizita e DPA për riakreditimin e Laboratorit

Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka një Sistem të Menaxhimit të Cilësisë për Laboratorin Analitik që funksionon mbi bazën e plotësisë së të gjitha kërkesave të standartit ISO 17025: 2017 "Kërkesa të përgjithshme për kompetencën e laboratorëve testues dhe kalibrues".

Laboratori i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit është i akredituar nga DPA për 11 parametra fiziko-kimike në ujë natyror dhe për matjen e nivelit të zhurmave. Afati i i vlefshmërisë së certifikatës të akreditimit të laboratorit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit - DPA (26.07.2021) është 25.07.2025 duke përfunduar kështu ciklin 4-vjeçar.


Në janar 2025 AKM paraqiti kërkesën pranë DPAPër fillimin e procesit të riakreditimit. Në këtë kuadër janë kryer procedurat për procesin e riakreditimit dhe në datë 28-29 Prill 2025, Laboratori mirëpriti grupin vlerësues të DPA për auditimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë në tërësi.



Qëllimi i vizitës ishte për të vlerësuar funksionimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë dhe aktivitetit të Laboratorit në përputhje me kërkesat e ISO 17025:2017.

Vlerësuesit vijuan me shqyrtim dokumentacioni, dosjesh, regjistrimesh dhe intervista me personelin e autorizuar, auditime të matjeve, kontrollet e vlefshmërisë.

Gjithashtu u krye kontrolli vertikal dhe testet me dëshmi.



### “Të dhënat e hapura”

Të dhënat e hapura në kontekstin evropian dhe transparencja për publikun.

Për të nxitur transparencën, inovacionin dhe efikasitetin, të dhënat e hapura janë kthyer në një burim thelbësor për institucionet publike dhe shoqërinë civile. Në këtë drejtim, Portali Evropian i të Dhënave, aktualisht pjesë e platformës [Data.europa.eu](https://data.europa.eu), luan një rol kyç duke ofruar akses të lehtë në një gamë të gjerë të të dhënave nga vende të ndryshme të Evropës.

Zhvillimi dhe zbatimi i politikave evropiane të të dhënave kërkon një kuptim të thelluar të dimensionit politik dhe angazhimin e institucioneve, agjencive dhe organeve evropiane që bashkëpunojnë ngushtë për të harmonizuar standardet dhe për të rritur ndërveprueshmërinë e sistemeve të të dhënave.

Një rol thelbësor luhet gjithashtu nga administratat publike kombëtare, ofruesit e të dhënave, si dhe organet ndërkombëtare, të cilat kontribuojnë në pasurimin dhe shpërndarjen e të dhënave. Gjeoportalet, së bashku me portalet kombëtare, rajonale dhe lokale të të dhënave, krijojnë një rrjet të integruar që u mundëson qytetarëve, studiuesve dhe bizneseve të aksesojnë informacion të vlefshëm në mënyrë të hapur dhe të lirë.

Në këtë kontekst u organizua nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit më 30 prill 2025, Tiranë “Seminar mbi të Dhënat e Hapura”.



Ky seminar synon të nxisë dialogun dhe shkëmbimin e njohurive mbi praktikën e të dhënave të hapura dhe vlerësimin e gatishmërisë për të dhëna në Shqipëri. Të krijojë një platformë dialogu dhe bashkëpunimi për të thelluar kuptimin mbi rolin e të dhënave të hapura në forcimin e transparencës institucionale, nxitjen e inovacionit dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike. Një nga çështjet kryesore ishte vlerësimi i gjendjes aktuale të të dhënave në Shqipëri, me synimin për të identifikuar jo vetëm praktikën pozitive ekzistuese, por edhe boshllëqet që kërkojnë ndërhyrje dhe zhvillim të mëtejshëm.

Përmes këtij seminari pritet të promovohet bashkëpunimi ndërmjet institucioneve shtetërore dhe partnerëve ndërkombëtarë për ndërtimin e strategjive afatgjata dhe të qëndrueshme për publikimin dhe përdorimin e të dhënave të hapura. Gjithashtu u ndanë përvoja dhe praktika më të mira ndërkombëtare në fushën e menaxhimit të të dhënave të hapura, duke u ndalur te mënyrat konkrete se si këto praktika mund të përshtaten në kontekstin shqiptar.

### Procedura për informimin paraprak të pëlqimit

Përfaqësuesi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM-së) i emëruar si Pikë Fokale e Konventës së Roterdamit gjatë kësaj periudhe Janar-Prill 2025 ka marrë pjesë në disa takime online për Procedurën PIC (Prior Information Consent) dhe ne kuader të saj gjatë kësaj periudhe janë marrë 17 Njoftime Eksporti nga ECHA.

Për të forcuar legjislacionin kombëtar të kimikateve në fuqi, për çdo njoftim të marrë, Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar në bashkëpunim me institucionet që merr pjesë në autorizimin e kimikateve në Shqipëri, ka kryer një proces verifikimi, ka përgatitur formatet për dhënien e përgjigjeve në lidhje me procedurat e PIC, bazuar në zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 665, datë 21.9.2016, për eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme.

